

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

### PER BLERJE MATERIALESH NDERTIMI PER NEVOJAT E OBJEKTEVE TE BASHKISE FINIQ

#### 1. BETON I GATSHEM STRUKTUROR C20/25

Kontraktori do te furnizoje me beton te gatshem **C20/25** Bashkine Finiq duke respektuar Standartin Shqiptar dhe ate European **SSH-EN206** si dhe "Regullat teknike per perdorimin e betoneve strukturore" miratuar me **V.K.M. Nr.679 Date 22.10.2004**.

Betoni i gatshem strukturor klasifikohet ne baze te rezistences ne shtypje e shprehur ne rezistence karakteristike **Rck ose fck**. Per betonin e gatshem **C20/25** vlerat e provave ne shtypje pas 28 ditesh ngurtesimi te kubikeve te betonit te marra ne objekt duhet te jene ne shifrat e mepeshtme:

#### Beton i gatshem C20/25

$Fck = 20 \text{ N/mm}^2$  (Vlera e marre nga provat ne shtypje mbi cilindrin me diameter 150mm dhe lartesi 300mm)

$Rck = 25 \text{ N/mm}^2$  (Vlera e marre nga provat ne shtypje mbi kubiket me brinje 150mm)

**Porosia e betonit per sasine, kohen dhe objektin ku do te hidhet nga kontraktori, do te behet nga Bashkia Finiq (ne rolin e bleresit), 2 dite para dites se furnizimit. Sasia e betonit te gatshem qe kerkon te furnizohet Bashkia Finiq do te perdoret ne rikonstruksionin e akseve rurale e urbane te kesaj bashkie.**

Kontraktori ka per detyre marrjen e mostrave te betonit ne objekt ne prani te perfaquesuesit te Kontraktuesit (Bashkia Finiq) si dhe kryerjen e provave laboratorike per percaktimin e rezistences se betonit ne shtypje pas 28 ditesh ngurtesimi dhe rezultatet e provave duhet te jene ne shifrat e permendura me larte. Keto prova perbejne edhe certifikaten e cilesise se betonit.

**Kontaktori duhet te beje furnizimin me beton te gashem si edhe hedhjen e tij ne objektet e Bashkise Finiq. Koha optimale qe nevojitet nga moment i prodhimit te betonit te gatshem ne nyje, transporti dhe**

**hedhja e tij ne objekt eshte 3-4 ore,kohe qe korespondon me prezen(ngurtesimin) e betonit,per te pasur betone cilesore ne objekte.**

**Inertet (te imta dhe te trasha)** per te gjitha tipet e betonit duhet te perdoren duke respektuar STASH-512-78 (Standarti Shqiptar) ose ne perputhje me ASTM C 33 "Inertet e betonit nga burime natyrale". Ato duhet te jene te forte dhe te qendrueshem dhe nuk duhet te permbajne materiale te demshme qe veprojne kunder fortese se qendruesherise se betonit ose, ne rast te betonarmese mund te shkaterroje kte perfocim. Materialet e perdonura si inerte duhet te perfotohen nga burimet te njohura per te arritur rezultate te kenaqshme per klasa te ndryshme te betonit.

## **2. INERTET**

Rere guri **dhe çakell makinerie** e prodhuar nga thyerja dhe fraksionimi ne makineri I materialeve guore ose zhavorre lumi me fortesi **800 kg/cm<sup>2</sup>** dhe te respekoje kushtet teknike te **Standartit Shqiptar STASH-512-78** dhe te mos kete permbajtje te huaj argjilore me shume se **5%** dhe material organike jo me shume se **3%**. Rera e makinerise duhet te kete granulometrine (0-5)mm,ndersa çakelli i makinerise (20-60)mm.

## **3. GURE KAVE**

Duhet te jene te produara ne kariera guri,te kene fortesi **600-800 kg/cm<sup>2</sup>**,permbajtje te argjiles me pak se **10%** dhe permbajtje te mbeturinave bimore me pak se **5%**. Guret e kaves do te perdoren nga enti prokurues per ndertimin e mureve prite se e mbajtese ne akset rrugore te tij.

## **4. TOMBINOT Ø400mm,Ø 600mm**

**Tombinot** duhet te jene rrethore me dimensionet e mesiperme qe i korespondon diametrit te brendshem, duhet te perballojne ngarkesat e levizshme **N-18 dhe T-80** dhe te prodhohen ne perputhje me **Standartin Shteteror ne fuqi STASH-2503-87**.

## **5. ÇIMENTO**

Duhet te jete "**Portland**" ,**M400** dhe ne perputhje me kushtet e Standartit Shteteror **STASH-501-87**.

Çertifikata e cilesise dhe fletet e analizave te fabrikave qe kane prodhuar çimenton duhet te shoqerojne cdo furnizim sipas porosise se entit prokurues, duke vertetuar qe çimentoja eshte e testuar dhe i ka plotesuar kerkesat e permendura me lart.

## **6. Zgare hekuri** per shtresa betoni ne rruge duhet te jete me hekur **Ø4mm** dhe me permasa te zgas

**(4.70\*2)m**.si dhe me permasa te kuadratit (25\*25)cm.

